**KODI Nr. 03/L-193**

# I DREJTËSISË PËR TË MITUR

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

# KOD TË DREJTËSISË PËR TË MITUR

## PJESA E PARË
## PARIMET UDHËZUESE DHE DISPOZITAT HYRËSE

## KREU I

### Neni 1
### Qëllimi i Kodit

1. Ky Kod rregullon procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore si dhe procedurën e ndërmjetësimit për të mitur.

### Neni 2
### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në ketë kod kanë këto kuptime:

1.1. **Fëmijë** - personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

1.2. **I mitur** - personi ndërmjet moshës katërmbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.

1.3. **I mitur i ri** - personi ndërmjet moshës katërmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.

1.4. **I mitur i rritur** - personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.

1.5. **Madhor i ri** - personi ndërmjet moshës tetëmbëdhjetë (18) dhe njëzetenjë (21) vjet.

1.6. **I ri** - fëmijë apo madhor i ri.

1.7. **Madhor -** personi i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

1.8. **Edukim i specializuar** - program edukativ i përpiluar sipas nevojave speciale të kryerësit të veprës penale, i cili synon të ndihmojë zhvillimin e gjithëmbarshëm adekuat të tij dhe të zvogëlojë mundësinë e recidivizmit.

1.9. **Burgim për të mitur -** dënim me burgim i shqiptuar ndaj kryerësit të mitur ose ndaj madhorit, që është në pajtim me Kreun IV të këtij Kodi.

1.10. **Objekt për kujdes të posaçëm -** institucion i cili siguron trajtim të personave me paaftësi mendore, psikologjike, sociale apo fizike.

1.11. **Organ i kujdestarisë -** organi përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale i cili është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve.

1.12. **Gjyqtar për të mitur -** gjyqtar profesional i cili është ekspert në çështjet penale ku janë të përfshirë fëmijët dhe madhorët e rinj, dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod.

1.13. **Prokuror për të mitur -** prokuror profesional i cili është ekspert në çështjet penale ku janë të përfshirë fëmijët dhe madhorët e rinj, dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod

1.14. **Trup gjykues për të mitur -** trup gjykues - kolegj i themeluar në pajtim me Kreun X të këtij Kodi, i cili ka së paku një (1) gjyqtar për të mitur dhe është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod.

1.15. **Shërbim sprovues** - institucioni i cili e bën ekzekutimin e masave dhe të dënimeve alternative.

## Neni 3
## Parimet udhëzuese

1. Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.

2. Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës.

3. Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjate kohës se privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.

4. Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht.

5. Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.

6. Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme.

7. Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur.

## Neni 4
## Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen ndaj secilit person të dyshuar për vepër penale të kryer si i mitur, pavarësisht nga mosha e tij në kohën e fillimit të procedurës.

2. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe ndaj çdo personi të dyshuar për vepër penale të kryer si madhor i ri.

3. Kur madhori akuzohet për vepër penale të kryer si i mitur, nenet 44 dhe 48 të këtij Kodi nuk zbatohen.

## Neni 5

Dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe të çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është rregulluar ndryshe.

## Neni 6

1. Në çdo kohë gjyqtari për të mitur mund të shqiptojë masa adekuate për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, duke përfshirë edhe vendosjen e fëmijës në strehimore ose në institucion edukativ apo të ngjashëm, vendosjen e fëmijës nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose transferimin e fëmijës në familje tjetër, nëse është e nevojshme që fëmija të ndahet nga mjedisi në të cilin ai ka jetuar ose për t'i ofruar ndihmë, mbrojtje a strehim. Gjyqtari për të mitur e njofton organin e kujdestarisë për cilëndo masë të shqiptuar.

2. Organi i kujdestarisë apo përfaqësuesi i autorizuar i fëmijës nga gjyqtari për të mitur, mund të kërkojë shqiptimin e masës adekuate për mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës.

3. Shpenzimet e strehimit për të miturin paguhen nga mjetet buxhetore dhe llogariten në shpenzimet e procedurës penale.

# PJESA E DYTË

## KREU II
## MASAT DHE DËNIMET E ZBATUESHME

## Neni 7
## Masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve

1. Masat që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: masat e diversitetit dhe masat edukative.

2. Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.

3. Dënimi nuk mund t'i shqiptohet të miturit i cili ka qene nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në kohën e kryerjes se veprës penale.

4. Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës në pajtim me këtë Kod.

5. Kur gjykata cakton dënimin me burgim për të mitur deri në dy (2) vjet ose masën e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy (2) vjet, mund të shqiptojë dënimin me kusht në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.

6. Përveç masës apo dënimit, të miturit mund t'i shqiptohet masa apo dënim nga Kreun VIII i këtij Kodi.

**Neni 8**
**Zgjedhja e masave dhe e dënimeve të zbatueshme**

1. Kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe këto rrethana: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.

2. Shërbimi sprovues përgatit anketë të plotë sociale për të miturin me kërkesë të prokurorit publik, gjyqtarit për të mitur ose gjykatës ashtu siç është paraparë në këtë Kod. Anketa sociale përfshin të dhëna mbi moshën e të miturit dhe zhvillimin psikologjik, biografinë e familjes, biografinë dhe rrethanat nën të cilat jeton i mituri, nivelin shkollor, përvojën edukative dhe çfarëdo të dhëne tjetër relevante.

3. Para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata mund të kërkojë nga shërbimi sprovues raportin para ndëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit.

**Neni 9**
**Shqiptimi i masave ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet**

1. Procedura gjyqësore nuk mund të zbatohet ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën njëzetenjë (21) vjet për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.

2. Procedura gjyqësore mund të zbatohet ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet vetëm nëse vepra penale është e dënueshme me më shumë se pesë (5) vite burgim. Në procedurën e tillë gjyqësore, gjykata mund të shqiptojë vetëm masën edukative adekuate institucionale. Kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 8 të këtij Kodi do të merren parasysh së bashku me kohën që ka kaluar nga kryerja e veprës penale.

**Neni 10**
**Shqiptimi i masave dhe i dënimeve ndaj madhorit për vepra penale të kryera si i mitur i cili ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet**

1. Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit për vepër penale të kryer si i mitur, i cili ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, gjykata mund të shqiptojë ndonjë masë ose dënim në pajtim me nenin 7 të këtij Kodi. Kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 8 të këtij Kodi merren parasysh bashkë me kohën që ka kaluar nga kryerja e veprës penale.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, gjykata, në vend të burgimit për të mitur mund të shqiptojë burgim ose dënim me kusht ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën njëzetenjë (21) vjet në kohën e procedurës gjyqësore.

3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në vend të burgimit për të mitur, gjykata shqipton burgim ose dënim me kusht ndaj madhorit i cili ka mbushur moshën njëzetetre (23) vjet në kohën e procedurës gjyqësore, nën kushtet e parapara në këtë Kod.

**Neni 11**
**Shqiptimi i masave ose i dënimeve ndaj madhorit të ri për vepër penale të kryer si madhor i ri**

1. Në procedurën gjyqësore të zbatuar ndaj madhorit të ri i cili nuk ka arritur moshën njëzetenjë (21) vjet për vepër penale të kryer si madhor i ri, gjykata mund të shqiptojë masë ose dënim në pajtim me nenin 7 të këtij Kodi, nëse çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit gjithashtu do të arrihej edhe me shqiptimin e masës ose dënimit, duke marrë parasysh rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe interesin e tij më të mirë.

2. Masa ose dënimi i shqiptuar mund të zgjasë derisa personi të arrij moshën njëzetetre (23) vjet.

**Neni 12**
**Efekti i dënimit në masën edukative**

1. Kur gjykata shqipton dënim me burgim për të mitur ndaj të miturit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet gjatë ekzekutimit të masës edukative, masa edukative pushon kur i mituri fillon mbajtjen e dënimit.

2. Kur gjykata shqipton ndonjë dënim me burgim për të mitur ose së paku një (1) vit burgim ndaj madhorit gjatë ekzekutimit të masës edukative, masa edukative pushon kur kryerësi fillon mbajtjen e dënimit.

3. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim për të mitur ose burgimin me kohëzgjatje më pak se një (1) vit ndaj madhorit gjatë ekzekutimit të masës edukative, gjykata në aktgjykimin e vet vendos për vazhdimin apo revokimin e masës edukative pas mbajtjes së dënimit me burgim për të mitur apo burgimit.

**Neni 13**
**Evidenca e masave dhe e dënimeve**

1. Gjykata mban evidencë të masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturit. Shërbimi sprovues duhet të ketë kopje të këtyre shënimeve.

2. Të dhënat mbi masat dhe dënimet e shqiptuara ndaj të miturit janë konfidenciale. Vetëm gjykata dhe prokuroria mund të marrin informatat e tilla kur kjo është e nevojshme për zbatimin e procedurës ndaj individit të njëjtë derisa ai është ende i mitur.

3. Shënimet nga paragrafi 1 i këtij neni do të fshihen kur personi të ketë arritur moshën njëzetenjë (21) vjet.

4. Kur ekzekutohet masa ose dënimi i shqiptuar ndaj madhorit për vepër penale të kryer si i mitur, shënimet mbi masën ose dënimin do të fshihen menjëherë pas përfundimit të masës ose dënimit.

## KREU III
## NDËRMJETËSIMI

**Neni 14**

1. Ndërmjetësimi është procedurë jashtëgjyqësore e cila zhvillohet nga personi i tretë, ndërmjetësuesi në pajtim me dispozitat e këtij Kodi dhe ligjit për ndërmjetësimin. Ndërmjetësimi

vjen në shprehje vetëm atëherë kur ekziston vullneti i lirë dhe pjesëmarrja e të dy palëve, kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar.

2. Prokurori, gjyqtari për të mitur apo kolegji për të mitur mund të propozoj ndërmjetësimin nëse vlerëson se do të jetë më e përshtatshme duke pas parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historia e të miturit, mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësia e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësia e rehabilitimit të të miturit dhe re-integrimi i tij në shoqëri.

3. Palëve në procedurë mund tu propozohet ndërmjetësimi në rast se ato kanë shprehur pëlqimin për ndërmjetësim.

**Neni 15**
**Ndërmjetësuesi**

1. Ndërmjetësuesi është person fizik, që i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara me Ligjin për ndërmjetësimin dhe është i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësuesve.

2. Ndërmjetësuesi ndihmon palët për të arritur marrëveshje.

3. Dispozitat për përjashtimin e gjyqtarit të përcaktuar ne Kodin e Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtateshmerisht edhe për përjashtimin e ndërmjetësuesit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

4. Përjashtimi i ndërmjetësuesit mund të kërkohet nga i mituri, prindi, prindi adoptues, kujdestari, avokati mbrojtës dhe pala e dëmtuar.

5. Kërkesa për përjashtim duhet të vendoset nga organi i cili e ka caktuar ndërmjetësuesin.

6. Kundër Aktvendimit mbi refuzimin e kërkesës për përjashtimin e ndërmjetësuesit nuk lejohet ankesa

## KREU IV
## MASAT E DIVERSITETIT

**Neni 16**
**Qëllimi i masave të diversitetit**

Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste.

**Neni 17**
**Kushtet për shqiptimin e masave të diversitetit**

1. Masa e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri (3) vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.

2. Kushtet për shqiptimin e masës së diversitetit janë:
   - 2.1. pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri;

2.2. shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe

2.3. pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.

3. Prokurori kompetent njoftohet menjëherë për moskryerjen e detyrimeve të masës së diversitetit nga i mituri i cili mund të vendosë për rifillimin e ndjekjes së rastit.

**Neni 18**
**Llojet e masave të diversitetit**

1. Masat e diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë:

1.1. pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;

1.2. pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;

1.3. kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit , të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;

1.4. vijimi i rregullt në shkollë;

1.5. pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;

1.6. kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë;

1.7. edukimi në rregullat e trafikut; dhe

1.8. këshillimi psikologjik.

**KREU V**
**MASAT EDUKATIVE**

**Neni 19**
**Qëllimi i masave edukative**

Qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.

**Neni 20**
**Llojet dhe kohëzgjatja e masave edukative**

1. Llojet e masave edukative që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale.

2. Masat disiplinore janë qortimi gjyqësor dhe dërgimi i të miturit në qendër disiplinore. Këto masa shqiptohen ndaj kryerësit të mitur interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.

3. Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen me masë afatgjate që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.

4. Masat institucionale edukative janë dërgimi i të miturit në institucion edukues, dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe me masë afatgjate, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit.

5. Kohëzgjatja e masës edukative nuk mund të kalojë afatin maksimal të burgimit të paraparë për veprën penale.

**Neni 21**
**Qortimi gjyqësor**

1. Gjykata e shqipton masën e qortimit gjyqësor kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes të të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij.

2. I mituri, të cilit i shqiptohet qortimi gjyqësor informohet se ai ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme e cila përbën vepër penale dhe i bëhet me dije se nëse përsëri kryen vepër të tillë, gjykata do t'i shqiptojë një masë apo dënim më të rëndë.

**Neni 22**
**Dërgimi në qendër disiplinore**

1. Gjykata shqipton masën e dërgimit në qendër disiplinore kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes më të mirë të të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij.

2. Gjykata mund ta dërgojë të miturin në qendër disiplinore:

2.1. më së shumti një (1) muaj, deri në katër (4) orë në ditë ose

2.2. më së shumti katër (4) ditë gjatë festës shkollore apo shtetërore, deri në tetë (8) orë në ditë.

3. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata kujdeset që ekzekutimi i saj të mos e pengojë shkollimin dhe punën e rregullt të të miturit.

4. Në qendrën disiplinore i mituri angazhohet në aktivitete të dobishme. Aktivitetet përshtaten me moshën e tij, shkathtësitë dhe interesat me qëllim të zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë tek ai.

**Neni 23**
**Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit**

1. Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, kur prindi, prindi adoptues apo

kujdestari është i aftë për mbikëqyrjen e të miturit, por që është treguar i pakujdesshëm ndaj mbikëqyrjes së tillë dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.

2. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata mund t'i jep prindit, prindit adoptues apo kujdestarit udhëzimet e nevojshme dhe ta urdhërojë atë në përmbushjen e detyrave të caktuara që janë pjesë e masës së shqiptuar me qëllim të përkujdesjes së të miturit dhe ndikimit pozitiv ndaj tij.

3. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata mund të urdhërojë shërbimin sprovues të verifikojë ekzekutimin e masës dhe t'i ofrojë ndihmën e nevojshme prindit, prindit adoptues ose kujdestarit.

**Neni 24**
**Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër**

1. Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e familjes tjetër pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues ose kujdestarit kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari është i paaftë për kryerjen e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturit dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.

2. Ekzekutimi i kësaj mase përfundon kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj tij apo kur sipas rezultateve të rehabilitimit nevoja për mbikëqyrje të shtuar pushon.

3. Kur shqiptohet kjo masë, gjykata gjithashtu mund të urdhërojë shërbimin sprovues të verifikojë ekzekutimin e masës dhe familjes që kryen mbikëqyrjen t'i ofrojë ndihmën e nevojshme

**Neni 25**
**Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë**

1. Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues apo kujdestarit kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari nuk është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.

2. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase, i mituri mbetet me prindin, prindin adoptues apo kujdestarin.

3. Me rastin e shqiptimit të kësaj mase, gjykata gjithashtu i cakton detyra organit të kujdestarisë, duke përfshirë:

3.1. mbikëqyrjen e edukimit të të miturit;

3.2. lehtësimin e qasjes në aftësimin profesional dhe punësimin;

3.3. sigurimin e largimit të të miturit nga çfarëdo ndikimi negativ;

3.4. lehtësimin e qasjes në kujdes të nevojshëm mjekësor;

3.5. ofrimin e zgjidhjeve të mundshme për ndonjë problem që mund të shfaqet në jetën e të miturit dhe

3.6. detyra të tjera që gjykata i çmon se do të ishin në interesin më të mirë të të miturit.

4. Organi i kujdestarisë është i detyruar ti raportoj gjykatës, e cila e ka shqiptuar masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e organit të kujdestarisë përkitazi me ekzekutimin e vendimit gjyqësor së paku çdo tre (3) muaj

## Neni 26
## Detyrimet e veçanta lidhur me masat e mbikëqyrjes së shtuar

1. Gjatë shqiptimit të njërës nga masat sipas neneve 23, 24 dhe 25 të këtij Kodi, gjykata mund të shqiptojë po ashtu një ose më shumë detyrime të veçanta, nëse gjykata konstaton se është e domosdoshme për ekzekutimin e suksesshëm të masës, me kusht që detyrimet e veçanta të mos e tejkalojnë afatin e masës.

2. Gjykata ndaj të miturit mund të shqiptojë këto detyrime të veçanta:

2.1. personalisht t'i kërkojë falje palës së dëmtuar;

2.2. palës së dëmtuar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me gjendjen financiare të të miturit;

2.3. të vijojë rregullisht shkollimin;

2.4. të pranojë punësimin ose të aftësohet për një profesion i cili i përshtatet shkathtësive dhe aftësive të tij;

2.5. të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;

2.6. të pranojë këshilla psikologjike;

2.7. të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri dhe

2.8. të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit.

3. Gjykata në çdo kohë mund t'ia ndërpresë ose ndryshojë detyrimet e veçanta që i janë shqiptuar të miturit.

4. Nëse i mituri nuk vepron në pajtim me detyrimet e veçanta të parapara në paragrafin 2. të këtij neni, gjykata mund ta zëvendësojë masën e mbikëqyrjes së shtuar me një masë tjetër edukative.

5. Kur i urdhëron detyrimet e veçanta të parapara në paragrafin 2., gjykata e informon të miturin se mos përmbushja e tyre mund të rezultojë me shqiptimin e një mase më të rëndë edukative.

## Neni 27
## Dërgimi në institucionin edukativ

1. Gjykata e shqipton masën e dërgimit në institucionin edukativ kur të miturit i nevojitet mbikëqyrje e plotë nga edukatorët adekuat dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të miturit.

2. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.

## Neni 28
## Dërgimi në institucionin edukativo–korrektues

1. Gjykata e shqipton masën e dërgimit në një institucion edukativo-korrektues kur i mituri i cili ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tre (3) vjet ka nevojë për edukim të specializuar dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit.

2. Kur gjykata vendos për shqiptimin e kësaj mase, ajo merr parasysh peshën dhe natyrën e veprës penale dhe nëse të miturit më parë i është shqiptuar masë edukative ose dënimi me burgim për të mitur.

3. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të zgjasë më pak se një (1) vit ose më shumë se pesë (5) vjet.

**Neni 29**
**Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm**

Gjykata mund të shqiptojë masën e dërgimit në një institucion për kujdes të posaçëm në vend të masës së dërgimit në institucion edukativ ose në institucion edukativo-korrektues me rekomandimin e ekspertit të mjekësisë kur të miturit i nevojitet përkujdesje e posaçme për shkak të çrregullimit mendor ose të metave fizike dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Gjykata e cila ka shqiptuar masën, çdo gjashtë (6) muaj e rishikon nevojën për qëndrim të mëtejshëm në institucionin e kujdesit të posaçëm si dhe kur i mituri arrin moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

**KREU VI**
**GJOBA DHE URDHËRI PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME**

**Neni 30**
**Gjoba**

1. Gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj të miturit nëse i mituri ka mjete për ta paguar gjobën. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe në veçanti lartësinë e të ardhurave të tij personale, të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet. Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri.

2. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëzetepesë (25) Euro ose më shumë se pesëmijë (5.000) Euro.

3. Me aktgjykim përcaktohet afati për pagesën e gjobës i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, por në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë pagesën e gjobës me këste po jo më gjatë se dy (2) vjet.

4. Nëse i mituri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata mund të lejojë që gjoba të paguhet me këste, por jo më gjatë se dy (2) vjet. Pastaj, nëse i mituri përsëri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund ta zëvendësojë gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme që nuk pengon vijimin e rregullt në shkollë dhe aktivitetet tjera të punës.

5. Gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë me ndonjë masë edukative jo institucionale, nëse i mituri nuk e paguan dënimin me gjobë, e as nuk pajtohet me zëvendësimin e saj me urdhrin me punë në dobi të përgjithshme

**Neni 31**
**Urdhri për punë në dobi të përgjithshme**

1. Me pajtimin e të miturit, gjykata mund ta zëvendësojë masën e shqiptuar edukative institucionale deri në tre (3) vjet, burgimin e të miturit deri në dy (2) vjet ose gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

2. Kur e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron të miturin që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej tridhjetë (30) deri në njëqindenjëzet (120) orëve. Shërbimi sprovues e përcakton llojin e punës në dobi të përgjithshme të cilën duhet ta kryejë personi i dënuar, cakton organizatën specifike për të cilën personi i dënuar do ta kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës kur do të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

3. Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda periudhës së caktuar nga gjykata, e cila nuk mund të zgjat më shumë se një (1) vit.

4. Nëse pas kalimit të periudhës së caktuar i mituri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose punën e tillë në dobi të përgjithshme e kryen vetëm pjesërisht, gjykata urdhëron ekzekutimin e masës institucionale edukative ose burgimin për të mitur në kohëzgjatje proporcionale, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që është kryer. Në rastin e gjobës, gjykata urdhëron pagesën e gjobës në përpjesëtim me kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme e cila nuk është kryer.

## KREU VII
## BURGIMI PËR TË MITUR

### Neni 32
### Qëllimi i burgimit për të mitur

Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin.

### Nen 33
### Shqiptimi i burgimit për të mitur

Gjykata mund të shqiptojë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili e ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe ka kryer vepër penale të dënueshme me mbi pesë (5) vite burgim, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuate për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale.

### Neni 34
### Kohëzgjatja e burgimit për të mitur

1. Kohëzgjatja e burgimit për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale por mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të paraparë për veprën penale.

2. Burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se gjashtë (6) muaj as më shume se pesë (5) vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë (10) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet.

3. Kur gjykata vendos për kohëzgjatjen e burgimit për të mitur, merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 8 të këtij Kodi dhe nenin 64, paragrafët 1. dhe 2. të Kodit Penal të Kosovës.

### Neni 35

**Lirimi me kusht nga burgimi për të mitur**

1. Personi i dënuar me burgim për të mitur mund të lirohet me kusht nëse e ka mbajtur së paku një të tretën (1/3) e dënimit që i është shqiptuar.

2. Kur lejohet lirimi me kusht, gjykata mund të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit apo organit të kujdestarisë i cili mund të zgjasë deri në përfundim të dënimit të shqiptuar.

3. Gjykata mund të revokojë lirimin me kusht nëse gjatë kohës së lirimit me kusht i mituri kryen vepër penale për të cilën shqiptohet burgimi ose burgimi për të mitur prej së paku gjashtë (6) muajve.

**Neni 36**
**Parashkrimi i ekzekutimit të burgimit për të mitur**

1. Dënimi me burgim për të mitur nuk mund të ekzekutohet pasi që të ketë kaluar periudha kohore si në vijim:

> 1.1. pesë (5) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgim për të mitur për më shumë se pesë (5) vjet;
>
> 1.2. tre (3) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgim për të mitur për më shumë se tre (3) vjet dhe
>
> 1.3. dy (2) vjet nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgimi për të mitur deri në tre (3) vjet.

**Neni 37**
**Shqiptimi i masës edukative dhe i burgimit për të mitur për vepra penale në bashkim**

1. Për vepra penale në bashkim gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm dënim me burgim për të mitur kur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit të tillë janë përmbushur dhe gjykata konstaton se ai duhet të shqiptohet.

2. Paragrafi 1 i këtij neni po ashtu zbatohet në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të masës edukative ose të burgimit për të mitur.

## KREU VIII
## MASAT E TRAJTIMI TË DETYRUESHËM DHE DËNIMET PLOTËSUESE

**Neni 38**
**Qëllimi dhe shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm**

1. Qëllimi i masës së trajtimit të detyrueshëm është që të kontribuojë në rehabilitimin e të miturit dhe të parandalojë rrezikun nga recidivizmi. Trajtimi i detyrueshëm shqiptohet në pajtim me dispozitat e Kodit penal të Kosovës.

2. Gjykata mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ndaj të miturit në pajtim me Ligjin për kryerësit me çrregullime mendore.

3. Gjykata mund të shqiptojë masën për trajtim të detyrueshëm të rehabilitimit ndaj të miturit në pajtim me kapitullin V të Kodit Penal të Kosovës .

4. Masa për trajtim të detyrueshëm shqiptohet vetëm pas konsultimit me shërbimin sprovues, organin e kujdestarisë dhe ekspertët përkatës.

5. Masa e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të shqiptohet në të njëjtën kohë me masën disiplinore.

**Neni 39**
**Shqiptimi i dënimeve plotësuese**

Kur gjykata e konsideron të arsyeshme mund të shqiptojë dënimin plotësues në pajtim më nenet 54-62 të Kodit Penal të Kosovës.

## PJESA E TRETË

## KREU IX
## PROCEDURA

**Neni 40**

1. Autoritetet ose institucionet që marrin pjesë në procedura gjyqësore që kanë të bëjnë me të miturit, si edhe personat dhe institucionet e tjera nga të cilët kërkohen njoftime, raporte dhe mendime janë të obliguar që të veprojnë shpejt dhe pa vonesa të panevojshme.

2. I mituri që është paraburgosur gjykohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

**Neni 41**

1. Për fëmijën nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet nuk fillon procedura gjyqësore. Nëse fëmija është nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet në kohën e kryerjes së veprës penale, çdo procedurë gjyqësore që ka filluar pushohet menjëherë dhe organi i kujdestarisë njoftohet për rastin nga prokurori.

2. Organi i kujdestarisë ndërmerr veprimet e caktuara në pajtim me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare për trajtimin e kryerësve të veprave penale nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjet në bazë të programeve të tij. Kjo çështje më hollësisht mund të rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

**Neni 42**

1. I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë.

2. Kur ndërmarrin ndonjë veprim në të cilin është i pranishëm i mituri dhe sidomos gjatë marrjes së tij në pyetje, organet që marrin pjesë në procedurë janë të obliguara që të veprojnë me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimin psikologjik, ndjeshmërinë dhe karakteristikat personale të të miturit në mënyrë që zbatimi i procedurës të mos ketë ndikim të kundërt në zhvillimin e tij.

**Neni 43**

1. I mituri duhet të ketë mbrojtës që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës:

2. Në rastet kur i mituri, përfaqësuesi ligjor ose anëtari i familjes së tij nuk angazhojnë mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent që e zbaton procedurën e emëron një (1) mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

3. Nëse i mituri mbetet pa mbrojtës gjatë rrjedhës së procedurës dhe nëse ai nuk mund të sigurojë tjetër mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent që e zbaton procedurën emëron një (1) mbrojtës të ri sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

4. Me kërkesën e të miturit, të përfaqësuesit ligjor ose të anëtarit të familjes së tij emërohet mbrojtës me shpenzime publike, nëse ai nuk mund t'i paguajë shpenzimet për mbrojtjen e vet, por jo kundër dëshirës së të miturit.

5. I mituri udhëzohet për të drejtën në mbrojtës me shpenzime publike sipas paragrafit 4. të këtij neni, para marrjes së parë në pyetje.

6. Të miturin mund ta përfaqësojë vetëm mbrojtësi i regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës.

**Neni 44**

1. Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në të gjitha procedurat dhe nga ata mund të kërkohet që të marrin pjesë nëse kjo është në interes të të miturit. Gjyqtari për të mitur mund ta përjashtojë prindin, prindin adoptues ose kujdestarin nga pjesëmarrja në procedurë nëse përjashtimi i tillë është në interesin më të mirë të të miturit.

2. Kur prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari i të miturit nuk e kryejnë detyrën e tyre prindore, gjykata mund të caktojë një (1) kujdestar të përkohshëm për të miturin.

3. Gjykatat mbajnë evidencë të përgatitur nga Qendra për Punë Sociale, për punëtorët socialë, arsimtarët, pedagogët ose specialistët vullnetarë nga mesi i të cilëve caktohet kujdestari i përkohshëm në rastet nga paragrafi 2. i këtij neni.

**Neni 45**

I mituri i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm mjekësor para fillimit paraqitjes së propozimit për caktimin e masës së paraburgimit, për tu siguruar se shëndeti i tij lejon caktimin e paraburgimit.

**Neni 46**

Askush nuk mund të përjashtohet nga detyra për të dëshmuar lidhur me rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit psikologjik të të miturit ose për njohjen e personalitetit të tij dhe të kushteve në të cilat jeton ai.

**Neni 47**

1. Kur i mituri ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale me një të rritur, procedura gjyqësore kundër të miturit ndahet dhe zbatohet sipas dispozitave të këtij kodi.

2. Në mënyrë të veçantë, procedura kundër të miturit mund të bashkohet me procedurën kundër të rriturit dhe mund të zbatohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, vetëm nëse bashkimi i procedurës është i nevojshëm për sqarim gjithëpërfshirës të rastit. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente merr vendim lidhur me këtë në bazë të propozimit të arsyeshëm të prokurorit ose mbrojtësit. Palët mund të ushtrojnë ankesë kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë brenda tri (3) ditëve nga marrja e aktvendimit.

3. Kur procedura e bashkuar zbatohet kundër të miturit dhe kryerësit madhor, dispozitat e nenit 40, nenet 42 - 46, neni 48, neni 49, neni 50 paragrafët 1 dhe 3, neni 64 - 68 dhe neni 71 i këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin në rastet kur çështjet që kanë të bëjnë me të miturin sqarohen në shqyrtim gjyqësor dhe nenet 79 dhe 80 të këtij Kodi zbatohen gjithmonë lidhur me të miturin, ndërsa dispozitat tjera të këtij Kodi zbatohen nëse aplikimi i tyre nuk është në kundërshtim me zbatimin e procedurës së përbashkët.

**Neni 48**

1. Në procedurë ndaj të miturve, pavarësisht nga kompetencat e parashikuara qartë në dispozitat e këtij Kodi, organi i kujdestarisë njoftohet për rrjedhën e procedurës, të bëjë propozime dhe të paraqesë fakte e prova të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë.

2. Prokurori e njofton organin kompetent të kujdestarisë kurdo që fillon procedura kundër të miturit.

**Neni 49**

1. I mituri ftohet në gjykatë personalisht dhe përmes prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të tij.

2. Të miturit i dorëzohen vendimet dhe dokumentet e tjera të shkruara në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës. Megjithatë dokumentet nuk i dorëzohen të miturit duke i ekspozuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe nuk zbatohen dispozitat e Kodit të procedurës penale.

**Neni 50**

1. Të gjitha procedurat në të cilat janë të përfshirë të miturit janë konfidenciale. Asnjë incizim i procedurës, duke përfshirë edhe audio dhe video incizimin, nuk mund të bëhet publik pa autorizimin e gjykatës.

2. Vetëm pjesa e vendimit të marrë gjatë procedurës që autorizohet për publikim bëhet publike.

3. Kur pjesa e autorizuar e incizimit të procedurës ose e vendimit bëhet publike nuk zbulohen të dhënat personale që mund të shfrytëzohen për identifikimin e të miturit.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen në procedurat ku përfshihen madhorët që gjykohen për vepra penale që i kanë kryer si të mitur.

## KREU X
## PËRBËRJA E TRUPIT GJYKUES PËR TË MITU

**Neni 51**

1. Trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së parë dhe trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së dytë, me përjashtim të kolegjeve në Gjykatën Supreme të Kosovës, përbëhet nga një (1) gjyqtar për të mitur dhe dy (2)gjyqtarë porotë. Gjyqtari për të mitur është kryetari i trupit gjykues.

2. Kolegji për të mitur në Gjykatën Supreme të Kosovës përbëhet nga tre (3) gjyqtarë duke përfshirë së paku një (1) gjyqtar për të mitur. Kur trupi gjykues për të mitur gjykon në shqyrtimin gjyqësor, do të përbëhet nga dy (2) gjyqtarë për të mitur dhe tre (3) gjyqtarë porotë.

3. Gjyqtarët porotë në trupin gjykues për të mitur emërohen nga mesi i profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve.

4. Gjyqtarët porotë që marrin pjesë në trupin gjykues për të mitur janë të gjinive të ndryshme.

**Neni 52**

1. Prokurori mund të pezullojë ndjekjen e veprës penale dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse janë plotësuar kushtet nga neni 17 i këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diversitetit, prokurori e thërret të miturin, prindin e tij, prindërit adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.

2. Gjyqtari për të mitur mund të shqiptojë masën e diversitetit nëse janë plotësuar kushtet nga neni 17 i këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diveristetit, gjyqtari për të mitur e thërret të miturin, prindin e tij, prindin adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin. Nëse gjyqtari për të mitur vendos të shqiptojë masën e diversitetit, pushohet çdo procedurë që është duke vazhduar.

**Neni 53**

1. Gjykata e shkallës së dytë është kompetente:

   1.1. të vendosë për ankesën kundër vendimit të trupit gjykues për të mitur të shqiptuar në shkallë të parë;

   1.2. të vendosë për ankesën kundër vendimit të prokurorit publik;

   1.3. të vendosë për ankesën kundër vendimit të gjyqtarit për të mitur dhe

   1.4. në rastet e tjera të veprojë ashtu siç parashihet me ligj.

**Neni 54**

1. Gjykata në territorin e së cilës është adresa e përhershme e vendbanimit të të miturit, sipas rregullit ka kompetencë territoriale për procedurë kundër të miturit.

2. Nëse i mituri nuk ka adresë të përhershme apo nëse adresa e tij nuk dihet, gjykata në territorin e së cilës aktualisht ndodhet vendbanimi i të miturit ka kompetencë territoriale.

3. Procedura mund të zbatohet në gjykatën në territorin e së cilës aktualisht ndodhet vendbanimi i të miturit, edhe kur ai ka vendbanim të përhershëm, ose në gjykatën në territorin e së cilës është kryer vepra penale nëse është e qartë që procedura do të zbatohet më lehtë në atë gjykatë.

## KREU XI
## PROCEDURA PËRGATITORE

**Neni 55**

1. Prokurori fillon procedurën përgatitore ndaj të miturit të caktuar në bazë të kallëzimit penal të policisë, kallëzimit penal nga persona të tjerë ose nga burime të tjera nëse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale.

2. Procedura përgatitore për vepra penale që ndiqen në bazë të propozimit për ndjekje penale ose të padisë private fillohet vetëm nga prokurori nëse pala e dëmtuar ia ka dorëzuar propozimin për fillimin e procedurës prokurorit publik brenda afatit të parashikuar në dispozitën e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**Neni 56**

1. Për veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre (3) vjet ose me gjobë, prokurori mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale, nëse prokurori mendon se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura kundër të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale.

2. Kur ndaj të miturit ekzekutohet dënimi ose masa, prokurori mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore për një vepër tjetër penale të kryer nga i mituri, nëse duke pasur parasysh peshën e asaj vepre penale, si dhe dënimin a masën e cila është duke u ekzekutuar, zbatimi i procedurës dhe shqiptimi i dënimit ose i masës për veprën penale nuk do t'i shërbente ndonjë qëllimi.

3. Nëse prokurori vendos të mos fillojë procedurën përgatitore, ai e njofton organin e kujdestarisë.

4. Për t'i vërtetuar rrethanat nga paragrafi 1. të këtij neni, prokurori mund të kërkojë që shërbimi sprovues ta bëjë një anketë sociale të parashikuar në nenin 8 të këtij Kodi. Nëse është e nevojshme, prokurori mund ta thirr prindin, prindin adoptues ose kujdestarin e të miturit, si edhe personat dhe institucionet e tjera dhe palën e dëmtuar.

5. Nëse për ndonjë arsye nuk është e mundur që anketa sociale sipas paragrafit 4 të këtij neni të përfundohet para se të merret vendimi për përshtatshmërinë e fillimit të procedurës përgatitore, prokurori i siguron informatat e nevojshme sipas nenit 8 të këtij Kodi dhe mund të konsultohet me shërbimin sprovues për vendimin e tij.

**Neni 57**

1. Procedura përgatitore fillohet me aktvendim të prokurorit. Në aktvendim përcaktohet i mituri ndaj të cilit zbatohet procedura përgatitore, koha e fillimit të procedurës përgatitore, përshkrimi i veprës që përcakton elementet e veprës penale, emërtimi ligjor i veprës penale, rrethanat dhe faktet që arsyetojnë dyshimin e bazuar për veprën penale, provat dhe informatat e mbledhura dhe raporti për ndonjë dënim ose masë të shqiptuar më parë ndaj të miturit. Një kopje e vulosur e aktvendimit mbi procedurën përgatitore i dërgohet pa vonesë gjyqtarit për të mitur.

2. Dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërisht në procedurën përgatitore.

**Neni 58**

1. Gjyqtari për të mitur cakton ekspert përkatës të shëndetit mendor kur është e nevojshme të vërtetohet gjendja e shëndetit mendor të të miturit qoftë në kohën e kryerjes së veprës penale ose të konstatojë aftësinë e të miturit për t'u gjykuar ose në të dyja rastet. Gjyqtari për të mitur caktimin e kësaj detyre e bën sipas detyrës zyrtare ose me kërkesën e prokurorit, të mbrojtësit, prindërve, prindërve adoptues a të kujdestarit. Kontrolli bëhet në ambient të përshtatshëm dhe konfidencial. Mendimi i ekspertit për shëndetin mendor është konfidencial dhe mund t'i zbulohet gjykatës dhe palëve.

2. Gjyqtari për të mitur mund të kërkojë nga shërbimi sprovues përgatitjen e raportit para ndëshkues.

**Neni 59**

1. Gjatë rrjedhës së procedurës përgatitore, gjyqtari për të mitur garanton të drejtat e të miturit.

2. Mbrojtësi dhe prindi, prindi adoptues, kujdestari i të miturit dhe organi i kujdestarisë mund të marrin pjesë në veprimet e marra gjatë procedurës përgatitore. Kur personat e tillë janë të pranishëm në veprimet e tilla, ata mund të bëjnë propozime dhe t'i shtrojnë pyetje personit që është duke u marrë në pyetje.

3. Marrja në pyetje e të miturit, në rastet kur është e nevojshme, ndërmerret me ndihmën e pedagogut, psikologut, defektologut, etj.

**Neni 60**

1. Prokuroi e pushon procedurën përgatitore kurdo që nga provat e mbledhura konstatohet se:

1.1. nuk ka dyshim të bazuar se i mituri ka kryer veprën e caktuar penale;

1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale;

1.3. vepra penale është përfshirë me falje;

1.4. janë prezente kushtet e parapara në nenin 56, në paragrafin 1 të këtij Kodi ose

1.5. ekzistojnë rrethana të tjera që pengojnë ndjekjen.

2. Prokurori menjëherë e informon gjyqtarin për të mitur për pushimin e procedurës përgatitore. Prokurori publik menjëherë e njofton edhe të miturin për pushimin e procedurës përgatitore, përveç rasteve kur nuk janë ndërmarrë veprime në procedurën përgatitore.

**Neni 61**

Nëse procedurat përgatitore nuk përfundohen brenda periudhës gjashtë (6) mujore, prokurori i dorëzon gjyqtarit për të mitur kërkesë të arsyetuar me shkrim për vazhdimin e procedurës përgatitore. Procedura përgatitore mund të vazhdohet në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës.

**Neni 62**

Para përfundimit të procedurës përgatitore, prokurori e njofton mbrojtësin për qëllimin e tij që të përfundojë procedurën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Gjatë kësaj periudhe mbrojtësi mund të parashtrojë kërkesë për marrjen parasysh të fakteve apo provave të reja në pajtim me nenin 59, paragrafi 2 të këtij Kodi. Nëse prokurori e miraton kërkesën, procedura përgatitore nuk përfundohet dhe nevojitet njoftim i ri për përfundimin e procedurës. Nëse nuk parashtrohet kërkesë, procedura përfundohet brenda afatit që i është komunikuar palëve. Prokurori nuk merr parasysh kërkesën për shqyrtimin e fakteve ose provave të reja pas përfundimit të procedurës përgatitore.

**Neni 63**

1. Pas përfundimit të procedurës përgatitore, prokurori mund të paraqesë propozim të arsyetuar pranë trupit gjykues për të mitur për shqiptimin e masës edukative ose dënimit.

2. Propozimi i prokurorit duhet të përfshijë: të dhënat personale të të miturit, përshkrimin e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale me përcaktimin e dispozitave në Kodin Penal të Kosovës, provat që tregojnë se i mituri e ka kryer veprën penale, rezultatet e ndonjë ankete sociale të përpiluar nga shërbimi sprovues dhe propozimin për shqiptimin e masës edukative ose dënimin ndaj të miturit, duke përfshirë arsyerat pse nuk është shqiptuar masa e diversitetit.

## KREU XII
## ARRESTI I PËRKOHSHËM, NDALIMI POLICOR DHE PARABURGIMI

### Neni 64

Arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi i të miturit urdhërohet vetëm si masë e fundit për një kohë sa më të shkurtër të mundshme.

### Neni 65

1. Policia mund të arrestojë dhe të ndalojë të miturin në pajtim me kapitullin XXIV të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

2. Arresti i përkohshëm apo ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën njëzetekatër (24) orësh. Pas kalimit të kësaj periudhe, policia e liron të miturin, përveç nëse gjyqtari për të mitur cakton paraburgim.

### Neni 66

1. Gjyqtari për të mitur mund të caktoj paraburgimin ndaj të miturit nëse ekzistojnë arsyet e përcaktuara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe nëse alternativat e paraburgimit nuk do të ishin të mjaftueshme për të siguruar praninë e të miturit, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës dhe për të siguruar zbatim të suksesshëm të procedurës. Gjyqtari për të mitur shqyrton nëse masat e parapara në nenin 6 të këtij Kodi ose në nenin 268 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës mund të urdhërohen si alternativë për paraburgimin. Aktvendimi mbi paraburgimin e të miturit përfshin një shpjegim të arsyetuar për pamjaftueshmërinë e alternativave kundruall paraburgimit.

2. I mituri mund të mbahet në paraburgim me aktvendim të gjyqtarit për të mitur për një periudhë maksimale prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur ai është arrestuar. Paraburgimi i të miturit mund të vazhdohet vetëm nga kolegji për të mitur i gjykatës kompetente për një periudhë shtesë deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.

3. Kolegji për të mitur i gjykatës kompetente e rishqyrton aktvendimin për paraburgim brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e aktvendimit. Rishqyrtimi i tillë bëhet në seancë dëgjimore në praninë e të miturit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit.

### Neni 67

1. Të miturit që mbahen në paraburgim në qendrën e paraburgimit ndahen nga të paraburgosurit madhor.

2. I mituri i cili mbahet në paraburgim mund të mbahet në institucionin edukativo korrektues nëse gjyqtari për të mitur konsideron se kjo është në interesin më të mirë të të miturit.

3. Derisa mbahet në paraburgim, të miturit, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike.

**Neni 68**

1. Dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërish për paraburgimin ndaj të miturit.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shume se dymbëdhjetë (12) muaj nga dita e arrestit

3. Gjyqtari për të mitur ka autorizime të njëjta lidhur me të miturin në paraburgim sikurse gjyqtari i procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës lidhur me të rriturit në paraburgim.

## KREU XIII
## SHQYRTIMI GJYQËSOR

**Neni 69**

1. Kur gjyqtari për të mitur merr propozimin nga prokurori, ai mund të merr aktvendim për hedhjen e propozimit apo transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, nëse ekzistojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

2. Nëse gjyqtari për të mitur nuk merr aktvendim për hedhjen e propozimit ose transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, ai e cakton shqyrtimin gjyqësor brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i propozimit.

3. Në çdo kohë, trupi gjykues për të mitur mund të pushojë procedurën në shqyrtimin gjyqësor dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse plotësohen kushtet nga neni 17 të këtij Kodi. Para vendosjes për masën e diversitetit, trupi gjykues për të mitur e thirr të miturin, prindin e tij, prindin adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.

**Neni 70**

1. I mituri, mbrojtësi dhe prokurori janë të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor.

2. Përveç personave të paraparë me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, përfaqësuesi i organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues thirren në shqyrtimin gjyqësor. Mosparaqitja e personave të tillë nuk e pengon gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.

3. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës lidhur me ndryshimin dhe zgjerimin e akuzës po ashtu vlejnë në procedurën ndaj të miturit. Megjithatë, trupi gjykues për të mitur është i autorizuar të marrë vendim, madje edhe nëse prokurori nuk ka ndryshuar propozimin e tij ose nëse nuk ka përgatitur propozim të ri, në bazë të provave që janë prezantuar në shqyrtimin gjyqësor, duke treguar se gjendja faktike siç është shpjeguar në propozim ka ndryshuar.

**Neni 71**

1. Publiku gjithmonë përjashtohet kur gjykohet i mituri.

2. Trupi gjykues për të mitur në shqyrtim gjyqësor mund të lejojë pjesëmarrjen e ekspertëve dhe personave të cilët profesionalisht trajtojnë mirëqenien dhe edukimin e të miturve ose luftimin e sjelljes delikuente për të të miturit.

3. Gjatë seancës gjyqësore trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që të gjithë personat ose personat e caktuar të largohen nga seanca me përjashtim të të miturit, prokurorit, mbrojtësit, përfaqësuesit të organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesit të shërbimit sprovues. Trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që prindi, prindi adoptues ose kujdestari të largohen nga shqyrtimi gjyqësor vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, nëse ka arsye për të besuar se kjo është në interesin më të mirë të të miturit.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen në procedurë ku përfshihen madhorët që gjykohen për vepra penale që i kanë kryer si të mitur.

**Neni 72**

Seanca gjyqësore shtyhet ose ndërprehet vetëm përjashtimisht. Gjyqtari për të mitur e njofton kryetarin e gjykatës për çdo shtyrje ose ndërprerje të seancës gjyqësore duke paraqitur arsyet për këtë.

**Neni 73**

1. Trupi gjykues për të mitur nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit me rastin e marrjes së vendimit të tij për llojin e masës ose dënimit që do të shqiptohet.

2. Trupi gjykues për të mitur e pushon procedurën në shqyrtim gjyqësor me aktvendim, kur ekzistojnë arsyet e parapara me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës.

3. Trupi gjykues për të mitur me aktvendim shqipton masën edukative për të miturin. Në dispozitiv të aktvendimit ceket vetëm urdhri për masën edukative dhe çfarëdo mase tjetër ose dënimi në kreun VIII të këtij Kodi, por i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale të përshkruar në propozimin e prokurorit. Arsyetimi i aktvendimit përmban përshkrimin e veprës penale dhe rrethanat të cilat e arsyetojnë shqiptimin e masës edukative.

4. Trupi gjykues për të mitur me aktgjykim shqipton dënimin ndaj të miturit. Aktgjykimi merret sipas dispozitave të Kodit të procedurës penale të Kosovës. Aktgjykimi gjithashtu përfshin urdhrin për cilëndo masë ose dënim në kreun VIII të këtij Kodi.

Neni 74

Gjyqtari për të mitur e përpilon aktvendimin ose aktgjykimin me shkrim brenda tetë (8) ditëve nga dita e shpalljes së tij, përjashtimisht në raste të ndërlikuara afati i përcaktuar mund të zgjatet me lejen e kryetarit të gjykatës por jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

**Neni 75**

1. Gjykata mund të urdhërojë të miturin t'i paguajë shpenzimet e procedurës dhe të plotësojë kërkesën pasuroro-juridike vetëm nëse të miturit i ka shqiptuar dënimin. Nëse të miturit i janë shqiptuar masat edukative, shpenzimet e procedurës gjyqësore paguhen nga buxheti i Kosovës kurse pala e dëmtuar për të realizuar kërkesën pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

2. Nëse i mituri ka të ardhura të veta financiare ose pronë, gjykata mund ta urdhërojë të miturin t'i paguajë shpenzimet e procedurës dhe ta plotësojë kërkesën pasurorojuridike madje edhe kur është shqiptuar masa edukative.

### Neni 76

Pjesa e katërt e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohet përshtatshmërisht në shqyrtimin gjyqësor për të mitur dhe në aktvendimin dhe aktgjykimin e marrë lidhur me të miturin.

## KREU XIV
## MJETET JURIDIKE

### Neni 77

1. Personat e paraparë me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës mund të ankohen kundër vendimit për shqiptimin e masave të diversitetit, aktvendimit për pushimin e procedurës në shqyrtim gjyqësor, aktvendimit për shqiptimin e masës edukative, kundër aktgjykimit për shqiptimin e dënimit dhe aktgjykimit apo aktvendimit për shqiptimin e masës nga kreun VIII të këtij Kodi. Kjo ankesë mund të paraqitet brenda tetë (8) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit ose të aktgjykimit.

2. Mbrojtësi, prokurori, bashkëshorti, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, i afërmi i gjakut në vijë të drejtë në cilëndo shkallë, vëllai ose motra mund të ushtrojnë ankesë në emër të të miturit madje edhe kundër dëshirës së tij.

3. I mituri nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij në ankesë.

4. Ankesa kundër aktvendimit me të cilin shqiptohet masa edukative që mbahet në institucion e pezullon ekzekutimin e masës. Gjykata mund të vendosë të ekzekutojë masën pavarësisht nga ankesa nëse konstaton se kjo është në interesin më të mirë të të miturit pasi ta dëgjojë të miturin, prindin e tij, prindin adoptues apo kujdestarin.

### Neni 78

1. Gjykata e shkallës së dytë mund ta ndryshojë vendimin ndaj të cilit është ushtruar ankesa duke e shqiptuar një masë më të rëndë vetëm nëse është kërkuar kjo në ankesën prokurorit.

2. Nëse me aktvendim ose me aktgjykim në shkallë të parë nuk është shqiptuar burgim për të mitur, gjykata e shkallës së dytë mund ta shqiptojë burgimin për të mitur vetëm nëse mbahet shqyrtimi. Nëse me aktvendim ose me aktgjykim në shkallë të parë nuk është shqiptuar ndonjë masë edukative institucionale, gjykata e shkallës së dytë mund ta shqiptojë masën edukative institucionale vetëm nëse mbahet shqyrtimi.

### Neni 79

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale, si dhe kur dënimi ose masa edukative i është shqiptuar të miturit me shkelje të dispozitave të këtij Kodi.

### Neni 80

Dispozitat për rishikim të procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtatshmërisht për rishikimin e procedurës ndaj të miturit, e cila është pushuar me aktvendim të formës së prerë në shqyrtim gjyqësor, me aktvendim të formës së prerë me të cilin shqiptohet masa edukative dhe me aktgjykim të formës së prerë me të cilin shqiptohet dënimi.

## PJESA E KATËRT
## NDËRMJETËSIMI DHE EKZEKUTIMI I MASAVE DHE I DËNIMEVE

## KREU XV
## PROCEDURA PËR NDËRMJETËSIM

### Neni 81

1. Para se palët të shkojnë në procedurën e ndërmjetësimit, prokurori ose gjyqtari për të mitur duhet që t'i njoftojë palët për parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit, si dhe për procesin dhe efektet ligjore të çdo marrëveshjeje që arrihet përmes ndërmjetësimit, në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim.

2. Kur kryerësi i mitur dhe pala e dëmtuar shprehin pëlqimin e tyre për ndërmjetësim, ky pëlqim duhet të shënohet në procesverbal.

3. Prokurori ose gjyqtari për të mitur me aktvendim emëron një ndërmjetës të pavarur nga lista e ndërmjetësuesve në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësimin.

4. Pas pranimit të aktvendimit që cakton ndërmjetësuesin, ndërmjetësuesi duhet që të vë kontakt me kryerësin e mitur dhe me palën e dëmtuar pastaj të fillojë procedurën e ndërmjetësimit.

5. Procedura e ndërmjetësimit nuk mund të zgjasë më tepër se nëntëdhjetë (90) ditë nga dita e nxjerrjes së aktvendimit. Për rezultatin e ndërmjetësimit njoftohet zyrtarisht Prokurori ose Gjyqtari për të mitur.

6. Nëse procedura e ndërmjetësimit nuk ka sukses, atëherë procedura gjyqësore duhet të vazhdojë nga aty ku është pezulluar.

7. Procedura e ndërmjetësimit për të mitur është pa pagesë për palët. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, duke përfshirë pagesën për ndërmjetësuesin, paguhen nga buxheti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në rastet kur ndërmjetësuesi caktohet nga gjyqtari për të mitur ose nga kolegji për të mitur, ndërsa në rastet kur ndërmjetësuesi caktohet nga Prokurori, shpenzimet e procedurës paguhen nga buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

8. Pagesa e shpenzimeve për procedurën e ndërmjetësimit dhe ndërmjetësuesit bëhet sipas ligjit për ndërmjetësimin dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij.

### Neni 82
### Përfundimi i Procedurës së Ndërmjetësimit

1. Procedura e ndërmjetësimit përfundohet atëherë kur:

 1.1. është kryer me sukses ndërmjetësimi;

 1.2. ka kaluar afati prej nëntëdhjetë (90) ditësh

1.3. ndërmjetësuesi konsideron se vazhdimi i procedurës së ndërmjetësimit nuk është i mundur ose është i paarsyeshëm;

1.4. i mituri ose pala e dëmtuar deklarojnë se dëshirojnë ta ndërpresin procedurën;

2. Kur ndërmjetësimi nuk ka sukses, prokurori, gjyqtari, ose kolegji për të mitur i cili ka propozuar ndërmjetësimin, rifillon procedurën e pezulluar nga momenti i pezullimit të tyre;

3. Kur ndërmjetësimi ka sukses, me aktvendim ndërpritet procedura gjyqësore apo ajo te prokurori ndaj kryerësit të mitur të veprës penale. Pasi të ndërpritet procedura gjyqësore, prokurori ose gjyqtari për të mitur duhet që t'i njoftojë palët lidhur me vendimin e tyre.

4. Po që se palët arrijnë marrëveshjen mbi kompensimin e dëmit, atëherë ajo i dorëzohet prokurorit ose gjyqtari për të mitur, dhe nëse ata e miratojnë, marrëveshja përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në pajtim me ligjin në fuqi.

## KREU XVI
## EKZEKUTIMI I MASAVE TË DIVERSITETIT

### Neni 83

1. Kur prokurori, gjyqtari për të mitur ose gjykata shqipton masën e diversitetit, aktvendimi dhe të gjitha informacionet dërgohen në shërbimin sprovues kompetent për ekzekutimin e kësaj mase.

2. Organi i cili e ka shqiptuar masën e diversitetit e mbikëqyrë ekzekutimin e masës së diversitetit.

3. Nëse i mituri nuk e përmbush detyrimin e urdhëruar si masë diversiteti, shërbimi sprovues verifikon faktet dhe arsyet e mos përmbushjes së detyrimit dhe e informon organin që e ka shqiptuar masën e diversitetit dhe prokurorin kompetent.

## KREU XVII
## EKZEKUTIMI I MASVE EDUKATIVE

### Neni 84
### Parimet e përgjithshme mbi ekzekutimin e masave edukative

1. Gjykata që ka shqiptuar masën edukative është kompetente për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masës edukative dhe për lëshimin e urdhrave lidhur me ekzekutimin e masës edukative.

2. Shërbimi Sprovues që ndodhet në territorin ku i mituri ka banim të përhershëm apo të përkohshëm është përgjegjës lidhur me ekzekutimin e masës edukuese.

### Neni 85

1. Masa edukative ekzekutohet duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të miturve, duke inkurajuar zhvillimin e tyre fizik, moral dhe intelektual, si dhe duke mbrojtur shëndetin e tyre fizik dhe mendor.

2. Masa edukative ekzekutohet bazuar në programin individual të adaptuar sa më shumë që të jetë e mundur sipas personalitetit të të miturit dhe të përgatitur në pajtim me të arriturat bashkohore të dijes dhe përvojës.

3. Programi individual është i përgatitur në bazë të analizave gjithëpërfshirëse të karakteristikave të veçanta të të miturit, shkaqeve dhe llojit të veprës penale dhe formave të tjera të vështirësive në sjellje, si dhe shkallës së arsimimit, zhvillimit të të miturit dhe rrethanave të jetës së tij familjare.

4. Programi individual përfshin mjete motivuese të cilat u janë adaptuar karakteristikave personale të të miturit, regjistrimit në shkollë dhe aftësim profesional, aktiviteteve të kohës së lirë, aktivitetit me prindërit, prindërit adoptues, kujdestarit apo anëtarëve të tjerë të familjes së të miturit dhe mënyrave të tjera të ushtrimit të ndikimit ndaj të miturit.

**Neni 86**

1. Shpenzimet për ekzekutimin e masës edukative paguhen nga buxheti i Kosovës.

2. Prindërit ose personat të cilët janë të obliguar me ligj të kujdesen për të miturin mund të obligohen që të kontribuojnë në pagimin e shpenzimeve për ekzekutimin e masës edukative.

3. Niveli i kontributit të prindërve apo i personave të cilët me ligj detyrohen të kujdesen për të miturin caktohet nga gjykata kur merr aktvendim për shqiptimin e masës edukative. Nëse caktimi i nivelit të kontributit kërkon një studim të detajuar të gjendjes financiare të prindërve apo personave të cilët me ligj detyrohen të kujdesen për të miturin, gjykata së pari merr aktvendim për shqiptimin e masës edukative dhe pastaj vazhdon procedurën për caktimin e nivelit të kontributit.

4. Gjykata kompetente mund ta ndryshojë vendimin për nivelin e kontributit nëse më vonë ndryshojnë rrethanat.

**Neni 87**

1. Masa edukative ekzekutohet pas vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe kur nuk ka më pengesa juridike për ekzekutimin e saj, përveç rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe.

2. Vendimin e formës së prerë gjykata ia dërgon institucionit të autorizuar apo individit për ekzekutim brenda tri (3) ditëve nga dita kur vendimi merr formë të prerë, së bashku me certifikatën e lindjes, dëftesën e shkollës ose dokumentin për transferim, raportin e kontrollit mjekësor, të dhënat nga dosja penale për vepra penale të mëhershme, procedurën e zbatuar dhe raportin e lëshuar nga shërbimi sprovues.

3. Institucioni i autorizuar apo individi i cili e pranon vendimin për ekzekutim e fillon ekzekutimin e dënimit brenda tre (3) ditëve nga pranimi i vendimit.

4. Gjykata kompetente ruan të dhënat për çdo të mitur ndaj të cilit është shqiptuar masë edukative.

**Neni 88**

Gjatë ekzekutimit të masës edukative, gjykata kompetente mund të shqiptojë masa adekuate për mbrojtjen e të drejtave dhe të mirëqenies së të miturit, duke përfshirë edhe vendosjen e të miturit në strehimore ose në institucionin edukativ apo të ngjashëm, vendosjen e të miturit nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose tranferimin e të miturit në ndonjë familje tjetër. Gjykata e njofton organin e kujdestarisë për cilëndo masë të shqiptuar.

**Neni 89**
**Ekzekutimi i masës së dërgimit në qendrën disiplinore**

Masa e dërgimit në qendër disiplinore për të mitur ekzekutohet në institucionin e posaçëm edukativ.

**Neni 90**

1. Prindi, prindi adoptues apo kujdestari duhet të sigurojë vizita të rregullta të të miturit në qendrën disiplinore.

2. Qendra disiplinore menjëherë e njofton gjykatën kompetente kur i mituri nuk paraqitet në kohën e caktuar në qendrën disiplinore apo kur ndërprenë vizitat e tij të rregullta.

3. Qendra disiplinore ruan shënimet mbi ekzekutimin e masës edukative e cila dorëzohet për inspektim në gjykatë dhe shërbimin sprovues.

**Neni 91**
**Ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari**

Ekzekutimi i masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari fillon kur prindi, prindi adoptues ose kujdestari pranon aktvendimin e formës së prerë mbi shqiptimin e masës edukative.

**Neni 92**

1. Prindi, prindi adoptues ose kujdestari i respektojnë urdhrat dhe udhëzimet e gjykatës e cila ka shqiptuar masën edukative dhe lejojnë shërbimin sprovues të verifikojë ekzekutimin e masës edukative kur verifikimi i tillë urdhërohet nga gjykata.

2. Kontesti ndërmjet prindërve, prindërve adoptues ose kujdestarit të të miturit dhe shërbimit sprovues zgjidhet pranë gjykatës kompetente.

**Neni 93**

1. Prindi, prindi adoptues ose kujdestari i të miturit dhe shërbimi sprovues e informojnë gjykatën kompetente mbi përparimin në ekzekutimin e masës edukative sipas kushteve të urdhëruara nga gjykata.

2. Shërbimi sprovues pa vonesë e informon gjykatën kompetente për mos përmbushjen e detyrimit të veçantë nga i mituri të shqiptuar në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi dhe për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.

**Neni 94**
**Ekzekutimi i masës për mbikëqyrje të shtuar në familjen tjetër**

1. Gjykata kompetente me propozim të shërbimit sprovues cakton familjen në të cilën vendoset i mituri ndaj të cilit është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër.

2. Para dorëzimit të propozimit, shërbimi sprovues analizon personalitetin e të miturit dhe strukturën sociale dhe psikologjike të familjes në të cilën ai do të vendoset.

3. Sipas kushteve të njëjta, përparësi i jepet familjes me të cilën i mituri është në lidhje farefisnore apo është i lidhur emocionalisht.

**Neni 95**

1. Shërbimi sprovues dhe familja në të cilën i mituri do të vendoset nënshkruajnë marrëveshje me shkrim që i rregullon të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta.

2. Familja ku i mituri duhet të vendoset lejon shërbimin sprovues ta verifikojë ekzekutimin e masës edukative, kur një verifikim i tillë urdhërohet nga gjykata.

**Neni 96**

Gjatë ekzekutimit të masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër, i mituri mbanë lidhje të përhershme me familjen e tij, përpos kur gjykata kompetente urdhëron ndryshe në bazë të propozimit të shërbimit sprovues.

**Neni 97**

Gjykata kompetente sipas detyrës zyrtare apo në bazë të propozimit të shërbimit sprovues mund të urdhërojë ndryshimin e vendit për të miturin, nëse rrethanat në familjen ku i mituri është i vendosur kanë ndryshuar në atë masë sa që ekzekutimi i masës edukative bëhet i vështirë.

**Neni 98**

Dispozitat e këtij Kodi mbi ekzekutimin e masës së mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues apo kujdestari zbatohen përshtatshmërisht në ekzekutimin e masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër.

**Neni 99**
**Ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë**

1. Organi kompetent i kujdestarisë është i autorizuar të ekzekutojë masën edukative të mbikëqyrjes së shtuar.

2. Organi i kujdestarisë menjëherë pas marrjes së aktvendimit për shqiptimin e masës edukative e cakton zyrtarin përgjegjës nga organi i kujdestarisë për ekzekutimin e masës dhe për këtë menjëherë e informon gjykatën kompetente.

**Neni 100**

1. Gjykatat, prokuroria, shkollat dhe institucionet tjera ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me organin e kujdestarisë në ekzekutimin e kësaj mase edukative.

2. Prindi, prindi adoptues apo prindi birësues i të miturit e informon organin e kujdestarisë për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.

3. Organi i kujdestarisë pa vonesë e informon gjykatën kompetente për mos përmbushjen e detyrimeve të posaçme të shqiptuara në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi nga ana e të miturit, si dhe për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.

4. Dispozitat e këtij Kodi mbi ekzekutimin e masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues apo kujdestarit zbatohen përshatshmërisht në rastet e ekzekutimit të masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë.

**Neni 101**

Dispozitat e këtij Kodi mbi ekzekutimin e masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e masës edukative të kujdesit të shtuar nga organi i kujdestarisë.

**Neni 102**
**Dispozitat e përgjithshme mbi masat edukative institucionale**

I mituri ndaj të cilit ekzekutohet masa edukative institucionale, krahas të drejtave të parashikuara me këtë Kod, gëzon të njëjtat të drejta sikurse madhori i dënuar me burgim.

**Neni 103**

1. Me kërkesën e të miturit ose prindit të tij, prindit adoptues ose kujdestarit ose me propozimin e shërbimit sprovues, ekzekutimi i masës edukative institucionale mund të shtyhet për shkaqe të arsyeshme.

2. Për shtyrjen e ekzekutimit vendos gjykata kompetente.

3. Ankesa kundër aktvendimit në shkallë të parë për shtyrjen e ekzekutimit mund të parashtrohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tre (3) ditëve nga marrja e aktvendimit.

**Neni 104**

1. Kërkesa ose propozimi për shtyrjen e ekzekutimit e shtyn ekzekutimin e masës edukative institucionale deri në marrjen e aktvendimit të formës së prerë për kërkesën apo propozimin.

2. Nëse gjykata duke e refuzuar kërkesën e cila është dorëzuar për herë të dytë, konstaton se e drejta për kërkesë po keqpërdoret, gjykata vendos që ankesa të mos e shtyj ekzekutimin e masës edukative institucionale.

**Neni 105**

Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale mbi shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për shtyrjen e ekzekutimit të masës edukative institucionale.

**Neni 106**

1. Me kërkesën e të miturit apo të prindit të tij, prindit adoptues ose kujdestarit, ose me propozimin e drejtorit të institucionit ku ekzekutohet masa edukative institucionale, masa edukative institucionale mund të pezullohet për arsye të justifikueshme deri në tre (3) muaj. Përjashtimisht, për qëllime të trajtimit, pezullimi mund të vazhdojë deri në përfundim të trajtimit.

2. Gjykata kompetente vendos për pezullimin.

3. Ankesa kundër aktvendimit në shkallë të parë mund të parashtrohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tre (3) ditëve nga marrja e aktvendimit.

**Neni 107**

1. Gjykata pezullon ekzekutimin e masës edukative institucionale edhe kur i mituri i është nënshtruar ekzekutimit të masës para hyrjes në fuqi të aktvendimit mbi kërkesën ose propozimin për shtyrje të ekzekutimit të masës dhe më vonë konstatohet se kërkesa ose propozimi ka qenë i bazuar.

2. Në rastin e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni, kohëzgjatja e ekzekutimit të masës edukative institucionale nuk llogaritet në kohëzgjatjen e pezullimit të ekzekutimit të masës edukative institucionale.

**Neni 108**

Masa edukative institucionale nuk konsiderohet se ekzekutohet gjatë periudhës së pezullimit të masës edukative institucionale.

**Neni 109**

Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale mbi pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për pezullimin e ekzekutimit të masës edukative institucionale.

**Neni 110**
**Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin edukativ**

1. Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ ekzekutohet në institucionin për edukimin e të miturve.

2. I mituri i cili i nënshtrohet masës edukative gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse të miturit e tjerë në institucionin edukativ. Vetëm drejtori i institucionit edukativ dhe edukatori përgjegjës i të miturit njoftohen për shqiptimin e masës edukative ndaj të miturit.

**Neni 111**

Shërbimi sprovues është i autorizuar për të urdhëruar të miturin të paraqitet në institucionin edukativ.

**Neni 112**

1. Nëse ekzekutimi i masës edukative nuk mund të fillojë ose të vazhdojë për shkak se i mituri refuzon të zbatojë masën edukative apo arratiset, shërbimi sprovues menjëherë e informon gjykatën kompetente dhe stacionin kompetent policor të cilët të miturin e transportojnë në institucionin edukativ.

2. Mënyra e transportimit të të miturit në institucionin edukativ nuk e cenon dinjitetin e tij.

**Neni 113**
**Ekzekutimi i masës së dorëzimit në institucionin edukativ korrektues**

1. Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ korrektues ekzekutohet në institucionin edukativ korrektues të themeluar për këtë qëllim. Institucioni edukativo korrektues është institucion korrektues i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur.

2. Femrat të cilat i nënshtrohen kësaj mase edukative vendosen në sektorin e femrave të institucionit edukativ korrektues.

3. Madhorët të cilët i nënshtrohen kësaj mase edukative, si dhe të miturit të cilët mbushin moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare në institucionin edukativ korrektues, vendosen në sektorin e veçantë në institucionin edukativ korrektues.

**Neni 114**

1. Gjykata kompetente me shkrim urdhëron të miturin të paraqitet në institucionin edukativo-korrektues në një ditë të caktuar për ekzekutimin e masës edukative korrektuese.

2. Periudha kohore nga marrja e urdhrit dhe dita e paraqitjes nuk do të jetë më e shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

3. Gjykata kompetente e informon institucionin edukativ korrektues për datën kur i mituri duhet të paraqitet dhe i dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale mbi të miturin të mbledhura gjatë procedurës.

**Neni 115**

1. Nëse i mituri i cili është thirrur sipas rregullit nuk paraqitet në institucionin edukativo-korrektues, gjykata urdhëron që ai të transportohet në institucionin edukativo korrektues. Nëse personi i dënuar fshihet ose ndodhet në arrati, gjykata urdhëron lëshimin e letër rreshtimit.

2. Mënyra e transportimit të të miturit në institucionin edukativo- korrektues nuk e cenon dinjitetin e tij.

**Neni 116**

1. Kur i mituri pranohet në institucionin edukativo-korrektues, së pari konstatohet identiteti i tij, arsyeja e shqiptimit të masës dhe organi që ka shqiptuar masën edukative, e më pas ai i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda njëzetekatër (24) orëve nga arritja. Emri i të miturit, arsyet dhe organi që ka shqiptuar masën edukative, data dhe koha për pranimin e tij në institucionin korrektues shënohet në regjistër.

2. I mituri më pas dërgohet në sektorin për kontroll personal por jo më gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë, me qëllim të përpilimit të programit individual. Programi me të cilin do të trajtohet i mituri hartohet nga grupi i ekspertëve dhe nga institucioni edukativo korrektues.

**Neni 117**

1. Të miturit ndahen në grupe edukative në harmoni me moshën e tyre, zhvillimin mendor dhe karakteristikat tjera në pajtim me veçoritë e programit të individializuar.
2. Grupi edukativ ka më së shumti njëzet (20) të mitur dhe një (1) edukator të veçantë.

**Neni 118**

1. I mituri ka të drejtë që të ushtrojë në mënyrë të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë.

2. Të miturit i garantohet një ambient i sigurt për t'u marrë me sport, për të ushtruar dhe për aktivitete të tjera fizike.

**Neni 119**

Nëse nuk ka orë mësimore për lëndë të caktuara ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijojë mësimin jashtë institucionit edukativo korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim.

**Neni 120**

1. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt.

2. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.

3. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues ka autorizimin për të ndaluar vizitat për shkaqe të justifikueshme në pajtim me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë

**Neni 121**

1. I mituri ka të drejtë në pushim ditor dhe javor në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

2. I mituri ka të drejtë në pushim vjetor prej tridhjetë (30) ditësh të cilat me leje të institucionit korrektues mund të shfrytëzohen edhe jashtë lokaleve të institucionit edukativo-korrektues.

3. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues të miturit mund t'i lejojë pushim shtesë nga institucioni edukativo-korrektues për arsye edukative, profesionale, familjare ose arsye të tjera sociale deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë çdo vit.

**Neni 122**

1. Dispozitat mbi procedurat disiplinore dhe dënimet të zbatueshme për personat e dënuar me burgim të paraparë në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale zbatohen përshtatshmërisht për të miturin i cili i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativo korrektues.

2. Të miturit nuk i shqiptohet izolimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor.

3. I mituri mund të vendoset në njësi të veçantë të institucionit edukativo-korrektues si dënim disiplinor nën kushtet vijuese:

   3.1. periudha e vendosjes në njësinë e veçantë nuk mund të kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë;

3.2. i mituri nuk vendoset i vetëm në njësinë e veçantë;

3.3. i mituri ka të drejtën të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë, në përputhje me nenin 118 të këtij Kodi dhe të pranoj vizita në përputhje me nenin 120 të këtij Kodi

3.4. i mituri ka qasje në tekste mësimore dhe libra të tjerë dhe

3.5. i mituri vizitohet nga zyrtari mjekësor dhe edukatori një (1) herë në ditë dhe dy (2) herë në javë nga drejtori i institucionit edukativo-korrektues.

**Neni 123**
**Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm**

I mituri të cilit i është shqiptuar masa edukative e dërgimit në institucionin e kujdesit të posaçëm për shkak të aftësive të kufizuara mendore apo fizike dërgohet në institucionin e posaçëm të mbrojtjes sociale, ku ai gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse të miturit e tjerë të vendosur në këtë institucion.

**Neni 124**

Me kërkesë të Shërbimit Sprovues, policia shoqëron të miturin në institucionin e kujdesit të posaçëm.

**Neni 125**

1. Nëse ekzekutimi i masës edukative e dërgimit në institucionin e kujdesit të posaçëm nuk mund të fillojë ose të vazhdojë për shkak se i mituri refuzon të zbatojë masën apo arratiset, shërbimi sprovues menjëherë e njofton gjykatën kompetente dhe stacionin policor kompetent, të cilët të miturin e transportojnë në institucion.

2. Mënyra e transportimit të të miturit në institucionin edukativ nuk e cenon dinjitetin e tij. Zyrtari mjekësor e shoqëron të miturin gjatë transportimit të tij në institucionin e kujdesit të posaçëm.

**Neni 126**

1. Institucioni i kujdesit të posaçëm e informon shërbimin sprovues kompetent dhe gjykatën kompetente mbi përparimin e ekzekutimit të masës edukative.

2. Institucioni veçanërisht e informon gjykatën kompetente për gjendjen shëndetësore të të miturit kur ai mbush moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

**Neni 127**
**Shqyrtimi, zëvendësimi dhe pushimi i masave edukative**

1. Çdo gjashtë (6) muaj, drejtori i institucionit apo qendrës, ku ekzekutohet masa edukative gjykatës dhe shërbimit sprovues kompetent i dorëzon raport për sjelljen e të miturit dhe suksesin në ekzekutimin e masës. Varësisht nga suksesi i ekzekutimit të masës, drejtori paraqet propozim për ndryshimin apo pushimin e ekzekutimit të masës edukative.

2. Çdo gjashtë (6) muaj, gjyqtari për të mitur i viziton të miturit e vendosur në institucion apo qendër, dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të miturit dhe zyrtarëve drejtpërdrejtë të përfshirë në ekzekutimin e masës edukative institucionale dhe pas shqyrtimit të shënimeve të

institucionit apo qendrës, konstaton nëse të miturit trajtohen në mënyrë korrekte dhe në pajtim me ligjin, dhe nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme.

3. Gjyqtari për të mitur menjëherë e informon shërbimin sprovues kompetent dhe institucionin ose qendrën që ekzekuton masën edukative institucionale për çfarëdo të mete apo vërejtje tjetër. Pas marrjes së informatave të tilla, shërbimi sprovues menjëherë bën kontrollet adekuate dhe ndërmerr masa për korrigjimin e pa ligjshmërive dhe parregullsive, dhe gjykatën kompetente e informon për veprimet e ndërmarra.

**Neni 128**

1. Gjykata kompetente që ka shqiptuar masën edukative shqyrton ekzekutimin e masës edukative çdo gjashtë (6) muaj.

2. I mituri, prindi i tij, prindi adoptues apo kujdestari, qendra, institucioni apo vendi ku ekzekutohet masa edukative ose shërbimi sprovues mund të kërkojnë rishqyrtimin e ekzekutimit të masës edukative.

3. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente merr vendim për kërkesën të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni brenda tetë (8) ditësh nga pranimi i kërkesës. Ankesa kundër këtij vendimi mund të dorëzohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tri (3) ditësh nga pranimi i vendimit.

4. Gjatë shqyrtimit, gjykata kompetente i merr parasysh raportet e shërbimit sprovues dhe ato të drejtorit të institucionit apo qendrës ku një masë edukative institucionale ekzekutohet dhe dëgjon të miturin, prindin e tij, prindin adoptues a kujdestarin, avokatin mbrojtës, prokurorin dhe shërbimin sprovues.

5. Në bazë të rishqyrtimit, gjykata mund të vazhdojë apo të pushojë ekzekutimin e masës edukative apo atë ta zëvendësojë me një masë më të lehtë edukative.

6. Përjashtimisht nga paragrafi 5. i këtij neni, gjykata, masën edukative mund ta zëvendësojë me një masë më të rëndë edukative në rastin kur i mituri nuk i ka përmbushur detyrimet e posaçme të shqiptuara në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi.

**Neni 129**

1. Nëse pas marrjes së vendimit mbi shqiptimin e masës edukative, zbulohen rrethana tjera, fakte të reja ose fakte që kanë ekzistuar por që nuk kanë qenë të njohura në kohën kur vendimi është marrë, e të cilat në mënyrë të qartë do të ndikonin në zgjedhjen e masës, gjykata shqyrton vendimin dhe mund të pushojë ekzekutimin e masës apo atë mund ta zëvendësojë me ndonjë masë tjetër edukative. Gjykata nuk mund tëshqiptojë masë më të rëndë në bazë të rishqyrtimit të provave të reja.

2. Nëse ekzekutimi i masës edukative nuk ka filluar brenda një (1) viti nga data prej së cilës vendimi mbi shqiptimin e masës bëhet i formës së prerë, gjykata rishqyrton vendimin dhe vendos për ekzekutimin apo pushimin e masës ose zëvendësimin e saj me ndonjë masë tjetër edukative. Gjykata nuk mund të shqiptojë masë më të rëndë.

3. Nëse pa fajin e të miturit ekzekutimi i masës të dërgimit në qendrën disiplinore nuk ka filluar brenda gjashtë (6) muajve nga data prej së cilës vendimi mbi shqiptimin e masës merr formën e prerë, masa nuk do të ekzekutohet.

4. Rishqyrtimi i masës edukative në pajtim me këtë nen bëhet në pajtim me nenin 128 të këtij Kodi.

**Ankesat dhe lutjet**
**Neni 130**

Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga personat e dënuar me burgim vlejnë përshtatshmërisht për dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga të miturit që mbajnë masat edukative të dërgimit në qendrën disiplinore, dërgimit në institucionin korrektues, dërgimit në institucionin edukativo-korrektues apo dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm.

## KREU XVIII
## EKZEKUTIMI I DËNIMEVE

**Neni 131**
**Ekzekutimi i gjobës**

1. Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale lidhur me ekzekutimin e gjobës zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e gjobës të shqiptuara për të mitur.

2. Gjoba e shqiptuar ndaj të miturit e cila nuk është paguar nuk mund të zëvendësohet me burgim.

**Neni 132**
**Ekzekutimi i urdhrit për punë në dobitë përgjithshme**

1. Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për ekzekutimin e dënimit me kusht me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e urdhrave për punë në dobi të përgjithshme të shqiptuara ndaj të miturve.

2. Nëse është në interes të të miturit, shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë apo bashkëpunim me organin e kujdestarisë apo përfaqësuesin ligjor të të miturit.

3. Kujdes i veçantë duhet kushtuar që puna në dobi të përgjithshme të mos pengojë vijimin e rregullt në shkollë ose aktivitetet tjera të rëndësishme.

**Neni 133**

1. Gjykatës e cila e ka shqiptuar dënimin për punë në dobi të përgjithshme, zyrtarët e shërbimit sprovues i dorëzojnë raport me shkrim dhe e njoftojnë për çfarëdo pengese në ekzekutimin e kësaj mase.

2. Nëse i mituri nuk mund të kryejë punën në dobi të përgjithshme për shkak të ndryshimit të mëvonshëm të rrethanave për të cilat ai nuk është përgjegjës, shërbimi sprovues nga gjykata kërkon rishqyrtimin e urdhrit për punë në dobi të përgjithshme.

3. Varësisht nga rezultatet e arritura, gjykata mund ta ndryshojë urdhrin apo ta pushojë ekzekutimin e masës.

4. Shpenzimet lidhur me ekzekutimin masave të diversitetit, masave edukative dhe urdhrit për punë në dobi të përgjithshme bien në barrë të buxhetit të Kosovës.

**Neni 134**

**Ekzekutimi i burgut për të mitur**

1. Dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë dërgimin, pranimin, qëndrimin dhe shtyrjen e ekzekutimit, caktimin e grupeve arsimore, të drejtat në vizitë dhe angazhimin në ushtrime fizike, përcaktimin e punës dhe edukimin, mundësinë e shkollimit të rregullt, dënimet disiplinore të të miturve në institucionet edukative dhe procedurat për ankesa dhe lutje, gjithashtu vlejnë edhe për ekzekutimin e dënimeve me burg për të miturit.

2. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e dënimit me burgim për të mitur në rastet kur nuk janë në kundërshtim me këtë Kod.

3. I mituri i cili është dënuar me burgim për të mitur, krahas të drejtave të parapara me këtë Kod, gëzon të njëjtat të drejta si personi madhor i dënuar me burgim.

**Neni 135**

1. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, të miturve u ofrohet aftësim i duhur profesional i bazuar në njohuritë e tyre, shkathtësitë, interesimet dhe punën që është duke e kryer, varësisht prej mundësive të institucionit korrektues. Bazat e trajtimit përfshijnë punën e dobishme edukative me shpërblim përkatës, lehtësimin dhe inkurajimin e kontakteve mes të miturve dhe botës së jashtme përmes letrave, telefonit, pranimin e vizitave, vizitave në shtëpi, aktiviteteve sportive dhe ofrimit të kushteve të nevojshme për kryerjen e ritualeve fetare.

2. Stafi profesional i shërbimit që trajton të miturin duhet të ketë njohuri të duhura nga lëmi i pedagogjisë dhe psikologjisë.

**Neni 136**

1. Burgimi për të miturit mbahet në institucion korrektues për të mitur dhe, në raste të jashtëzakonshme, në pavijone të ndara të institucionit korrektues për persona madhorë. Institucioni korrektues për të mitur është i llojit gjysmë të hapur dhe të hapur. Përjashtimisht të miturit mund të mbajnë dënimin me burgim për të mitur në institucionin korrektues të tipit të mbyllur.

2. Meshkujt dhe femrat e vuajnë dënimin e tyre të burgimit të të miturve në institucione të ndara korrektuese apo në pavijone të ndara të institucioneve të tilla.

3. Të miturit të cilët bëhen madhor gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim të të miturit duhet të vendosen në pavijone të ndara të institucionit. Të miturit e mbajnë dënimin e tyre me burgim në institucionin korrektues për të mitur derisa të mbushin moshën njëzetetre (23) vjet. Nëse deri në këtë moshë ata nuk e kanë mbajtur dënimin e plotë, ata transferohen në institucionin korrektues për të rritur. Në raste të veçanta, personave të dënuar të cilët kanë mbushur njëzetetre (23) vjet mund t'u lejohet qëndrimi në institucionin korrektues për të mitur nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e përgatitjes ose aftësimit profesional të tyre, apo nëse pjesa e mbetur e dënimit të tyre që duhet mbajtur nuk është më e gjatë se gjashtë (6) muaj. Ata në asnjë mënyrë nuk mund të qëndrojnë në institucionin korrektues për të mitur pasi të kenë mbushur njëzeteshtatë (27) vjet.

4. Madhorëve të cilëve u është shqiptuar dënimi për të mitur vendosen në një pavijon të ndarë të institucionit.

5. Çdo vit, drejtori i institucionit ku ekzekutohet dënimi për të mitur është i obliguar t'ia paraqesë raportin gjykatës e cila e ka shqiptuar dënimin për të mitur për sjelljen e të miturit dhe ekzekutimin e burgimit të të miturit.

**Neni 137**

1. Si rregull, të miturit i vuajnë dënimet e tyre së bashku.

2. Me kërkesë të të miturit, drejtori i qendrës korrektuese mund të lejoj që i mituri të ndahet nga personat tjerë të dënuar, nëse drejtori çmon se shqetësimet e cekura në kërkesën e të miturit janë të arsyeshme dhe se nuk ka mundësi tjera për trajtimin e shqetësimeve të të miturit.

3. Drejtori i qendrës korrektuese mund t'i urdhëroj të miturit që të ndahet nga personat tjerë të dënuar, pa kërkesën e të miturit për ndarje të tillë, vetëm nëse masa e tillë është e nevojshme:

3.1. Për të parandaluar rrezikun për jetë apo shëndet të të miturit a personave të tjerë; ose

3.2. Për të parandaluar kërcënimin ndaj sigurisë së institucionit korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e të miturit brenda përbrenda gjithë njerëzve të burgut.

4. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ndarjen nga personat tjerë të dënuar aplikohen përshtatshmërisht për ndarjen e të miturit nga personat tjerë të dënuar.

**Neni 138**

1. Në përputhje me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë, drejtori i ndonjë institucioni mund t'i lejojë të miturit që të marrë pushim nga dy (2) herë në çdo vit për t'i vizituar prindërit, prindërit birësues, bashkëshortin(en) kujdestar(e), fëmijët, fëmijët e birësuar, vëllezërit dhe motrat e tij.

2. Pushimi zgjat deri në tridhjetë (30) ditë dhe sipas rregullit ai lejohet atëherë kur nuk mbahen mësimet.

**Neni 139**

1. I mituri ka të drejtë të kalojë të paktën tri (3) orë gjatë ditës në ambient të hapur brenda institucionit.

2. I mituri nuk i nënshtrohet vetmisë si dënim disiplinor.

**Neni 140**

Trupi gjykues për të mitur i gjykatës së qarkut, e cila ka shqiptuar dënimin vendos lidhur me kërkesën për mbrojtje gjyqësore ndaj masave dhe vendimeve të drejtorit të institucionit korrektues në të cilin personi i dënuar është duke e mbajtur dënimin me burgim për të mitur.

## KREU XIX
## NDIHMA PAS EKZEKUTIMIT TË MASAVE PËR EDUKIMIN INSTITUCIONAL OSE BURGIMIT TË TË MITURIT

**Neni 141**

1. Gjatë tërë kohës derisa një masë e edukimit institucional ose burgimi për të mitur është duke u ekzekutuar, shërbimi sprovues mban kontakte të përhershme me të miturin, familjen e tij dhe institucionin në të cilin është vendosur i mituri.

2. Jo më vonë se tre (3) muaj para lëshimit të të miturit, institucioni ose qendra korrektuese në të cilin është duke u zbatuar masa e edukimit institucional ose burgimi për të mitur i njofton prindërit e tij, prindërit birësues apo kujdestarë dhe shërbimin sprovues lidhur me këtë dhe ua propozon atyre masat për pranimin e të miturit.

**Neni 142**

1. Institucioni korrektues, prindi, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit e njofton Gjykatën dhe Shërbimin sprovues për lirimin e të miturit.

2. Shërbimi sprovues i ofron ndihmë të miturit pas lirimit për aq kohë sa ai ka nevojë, por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj. Nëse është në interesin e të miturit, Shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë ose bashkëpunim prej Organit të Kujdestarisë ose përfaqësuesit ligjor të të miturit.

**Neni 143**

1. Pas lirimit të të miturit, Organi i Kujdestarisë ndërmerr një kujdes të veçantë për të miturin i cili nuk ka prindër apo për të miturin rrethanat familjare të të cilit nuk janë zgjidhur.

2. Kujdesi, në veçanti përfshinë vendosjen, ushqimin, sigurimin e veshmbathjes, trajtimin mjekësor, rregullimin e rrethanave familjare, kryerjen e aftësimit profesional dhe punësimin e të miturit.

## KREU XX
## EKZEKUTIMI I MASVE PËR TRAJTIMIN E DETYRUESHËM REHABILITUES OSE TRAJTIMIN E DETYRUESHËM PSIKIATRIK

**Neni 144**

1. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe dispozitat e ligjit në fuqi mbi ekzekutimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të shqiptuar madhorëve, zbatohen përshtatshmërishtpër ekzekutimin e këtyre masave të shqiptuara ndaj të miturve.

2. I mituri e mban masën e trajtimit të detyrueshëm në pavijon të veçantë të institucionit për kujdes të posaçëm ku këto masa ekzekutohen.

# PJESA E PESTË
# PROCEDURA GJYQËSORE QË PËRFSHIJNË VEPRAT PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

## KREU XXI
## GJYKIMI I MADHORËVE PËR VEPRA PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

**Neni 145**

1. Trupi gjykues për të mitur dhe gjyqtari për të mitur i gjykojnë personat madhor për veprat penale në vijim të kryera kundër fëmijës, të parapara në Kodin Penal të Kosovës:

1.1. dhunimi ;

1.2. kryerja e akteve seksuale me kërcënim të nderit ose të autoritetit;

1.3. sulmi seksual;

1.4. degradimi i integritetit seksual;

1.5. keqpërdorimi seksual i personave me aftësi të kufizuara mendore ose emocionale ose me paaftësi mendore;

1.6. keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;

1.7. nxitja e akteve seksuale ose prekja seksuale nga personat nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;

1.8. shpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin ose profesionin;

1.9. mundësimi i prostitucionit;

1.10. keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi;

1.11. tregimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet;

1.12. marrëdhëniet seksuale brenda familjeve;

1.13. bashkëjetesa me persona nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në bashkësi jashtëmartesore;

1.14. ndryshimi i statusit familjar të fëmijës;

1.15. rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës;

1.16. keqtrajtimi ose braktisja e fëmijës;

1.17. shkelja e detyrimeve familjare;

1.18. shmangia nga ndihma për mjete jetese;

1.19. pengimi dhe mosekzekutim i masave për mbrojtjen e fëmijëve;

1.20. rekrutimi ose regjistrimi i personave ndërmjet moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet në konflikt të armatosur;

1.21. vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërisë dhe e punës së detyruar;

1.22. trafikimi me njerëz; dhe

1.23. fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz.

**Neni 146**

1. Procedura kundër personit që kryen vepër penale kundër fëmijës sipas nenit 145 të këtij Kodi zbatohet në pajtim me dispozitat e Kodit Procedurës Penale të Kosovës, përveç dispozitave për dhënien e urdhrit ndëshkimor i përcaktuar me dispozitat e Kodit të procedurës penale të Kosovës.

2. Veprat penale të kryera ndaj fëmijëve i hetojnë oficerët e policisë që specializohen në këtë lëmi.

**Neni 147**

1. Kur zbatohet procedurë për vepër penale e kryer ndaj fëmijës, autoritetet ose institucionet veprojnë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale, duke e pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton ai, në mënyrë që t'iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij. Kontrollimi i fëmijës bëhet me ndihmën e pedagogut, psikologut ose të ndonjë eksperti tjetër.

2. Nëse fëmija ndaj të cilit është kryer vepra penale nga neni 145 i këtij Kodi merret në pyetje si dëshmitar, marrja e tillë në pyetje zbatohet më së shumti dy (2) herë. Marrja në pyetje zbatohet me ndihmën e pedagogut, psikologut ose ndonjë eksperti tjetër. Gjykata mund të urdhërojë që dëshmitari të merret në pyetje jashtë gjykatores përmes televizionit me qark të mbyllur.

3. Fëmija ndaj të cilit është kryer vepër penale nga neni 145 i këtij Kodi, më mirë mund të merret në pyetje si dëshmitar në shtëpinë e tij ose në ndonjë lokacion tjetër ku ndodhet ai ose në qendrën për punë sociale se sa në gjykatë. Për marrjen e tillë në pyetje zbatohet paragrafi 2. i këtij neni.

4. Sipas paragrafit 2. të këtij neni, çdo incizim teknik i marrjes në pyetje përmes televizionit me qark të mbyllur asgjësohet brenda pesë (5) viteve nga hyrja në fuqi e aktgjykimit.

5. Neni 50 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht për procedurat ku përfshihen veprat penale të kryera ndaj fëmijës.

**Neni 148**

Gjyqtari për të mitur e informon organin kompetent të kujdestarisë për faktet dhe provat e vërtetuara në procedurë penale të cilat kanë kontribuuar ose kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, në mënyrë që të ndërmerren masa për mbrojtjen e të drejtave dhe të mirëqenies së fëmijës.

**Neni 149**

Nëse gjatë procedurës penale vërtetohet se prindi po i keqpërdor ose së tepërmi po i lë pas dore detyrat prindore dhe të drejtat, ose po i shkel të drejtat e fëmijës, prokurori e fillon procedurën jashtëkontestimore për heqjen e të drejtave për përkujdesje prindore nga prindi.

**Neni 150**

Sipas rregullit, gjykata në territorin e së cilës e ka vendbanimin e përhershëm pala e dëmtuar ka kompetencë territoriale për procedurën për veprat penale të kryera ndaj fëmijës, ndërsa procedura mund të zbatohet në gjykatën në territorin e së cilës është kryer vepra penale kur procedura pranë asaj gjykate zbatohet më lehtë.

**Neni 151**

Neni 51 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht në gjykimin e personit për vepër penale të kryer ndaj fëmijës sipas nenit 145 të këtij Kodi.

**Neni 152**

1. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës komunale dhe trupi gjykues për të mitur i gjykatës së qarkut në shkallën e parë përbëhet nga gjyqtari për të mitur dhe dy (2) gjyqtarë porotë. Kur trupi gjykues për të mitur e gjykon në shkallë të parë një vepër penale të dënueshme me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim afatgjatë, ai përbëhet nga dy (2) gjyqtarë, prej të cilëve njëri është gjyqtarë për të mitur dhe tre (3) gjyqtarë porotë.

2. Trupi gjykues për të mitur i Gjykatës Supreme të Kosovës përbëhet nga tre (3) gjyqtarë në rastet kur gjykon në shkallë të dytë. Kur trupi gjykues për të mitur gjykon personin për vepër penale të dënueshme me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet, ai përbëhet nga pesë (5) gjyqtarë, prej të cilëve tre (3) janë gjyqtarë për të mitur, ndërsa kur gjykon në shkallë të dytë me seancë shqyrtimi, trupi për të mitur përbëhet nga dy (2) gjyqtarë për të mitur dhe tre (3) gjyqtarë porotë. Kur gjykon në shkallë të tretë dhe vendos për mjete të jashtëzakonshme juridike, trupi gjykues përbëhet siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

3. Në rastet kur nuk ka seancë shqyrtimi, trupi gjykues përbëhet sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Megjithatë, së paku një (1) anëtar i trupit gjykues është gjyqtarë për të mitur.

4. Gjyqtar në procedurë të shkurtuar është gjyqtari për të mitur i gjykatës komunale.

**Neni 153**

Procedura lidhur me vepra penale të kryera ndaj fëmijës sipas nenit 145 të këtij Kodi zbatohet shpejtë dhe pa vonesa të paarsyeshme.

## PJESA E GJASHTË
## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

## KREU XXII
## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

**Neni 154**

Masa edukative institucionale e cila është shqiptuar me vendim të formës së prerë para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi nuk mund të vazhdojë më gjatë se periudha kohore e paraparë me këtë Kod.

**Neni 155**

Burgimi për të mitur i cili është shqiptuar me vendim të formës së prerë para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi për një periudhë më të gjatë se sa që ka mundur të shqiptohet në pajtim me nenin 34 paragrafi 2. i këtij Kodi, shkurtohet në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

**Neni 156**

Procedura përgatitore e filluar para 6 prillit 2004 por e cila nuk ka përfunduar deri në këtë datë, vazhdon dhe përfundon sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm në fuqi.

**Neni 157**

1. Sipas pjesës së tretë të këtij Kodi, procedura penale në shkallë të parë për të cilën është bërë propozim i prokurorit para 6 prillit 2004 por e cila nuk është përfunduar deri në këtë datë, vazhdon sipas dispozitave të mëparshme të ligjit në fuqi derisa:

1.1. procedura penale të pushohet me aktvendim të formës së prerë; ose

1.2. aktgjykimi i shqiptuar në shqyrtim gjyqësor të merr formë të prerë.

2. Procedura penale në shkallë të parë sipas pjesës së pestë të këtij Kodi në të cilën aktakuza, propozim akuza ose padia private janë ngritur para datës së hyrjes në fuqi të këtij Kodi por të cilat nuk janë përfunduar deri në këtë datë, vazhdojnë në pajtim me dispozitat e ligjit të mëparshëm në fuqi derisa:

2.1. procedura penale të pushohet me aktvendim të formës së prerë ose

2.2. aktgjykimi i shqiptuar në shqyrtim gjyqësor të merr formë të prerë.

**Neni 158**

Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi cilido afat i paraparë ecë, ai llogaritet në pajtim me dispozitat e këtij Kodi, përveç nëse afati i mëparshëm ka qenë më i gjatë ose dispozitat e këtij kreu e parashohin ndryshe.

**Neni 159**

Deri sa nuk themelohet Këshilli Prokurorial, kur ndërmjetësi caktohet nga prokurori, shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, duke përfshirë pagesën e ndërmjetësuesit paguhen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

**Neni 160**

Organet kompetente nxjerrin akte nënligjore për zbatimin e këtij Kodi në afat prej gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te këtij Kodi.

**Neni 161**

Ky kod  shfuqizon Ligjin penal për të mitur UNMIK, Rregulloren nr. 2004/8 të datës 20. 04. 2004 dhe çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

**Neni 162**

Ky kod hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Kodi Nr. 03/ L-193**
**8 korrik 2010**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-039-2010, datë 28.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu**